



BASHKIA KONISPOL

Plani Social Vendor

2025-2028

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	3
I. MISIONI, VIZIONI, VLERAT DHE PARIMET UDHËRRËFYESE	3
1. Vizioni	3
2. Misioni.....	3
3. Parimet e Planit Social Vendor	3
.....	4
II. ANALIZA E SITUATËS	4
1. Kuadri strategjik.....	4
2. Nevojat, shërbimet e ofruara dhe boshllëqet.....	5
Vlerësimi i nevojave	5
Të dhënat demografike	5
Të dhënat nga statistikat e mirëqenies dhe shërbimeve sociale	5
Ndihma Ekonomike për familjen në nevojë.....	5
Punëkërkuessit e papunë.....	6
Analiza e Punësimit dhe Formimit Profesional në Bashkinë Konispol	Error! Bookmark not defined.
Individë me aftësi të kufizuar.....	7
Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe/ose përkujdesje	8
Viktima të dhunës në familje.....	8
Individë/familje në nevojë për strehim social	9
Individë që kanë varësi nga alkooli	10
Individë që kanë varësi nga droga	11
Persona LGBTIQ+	11
Vlerësimi i nivelit aktual të shërbimeve	12
Analiza e burimeve njerëzore	12
Analiza SWOT për realizimin e Planit Social Lokal në Bashkinë Konispol	14
III. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT	14
IV. PLANI I VEPRIMIT	25
V. MONITORIMI DHE VLERËSIMI	1
VI. ANEKSI 1 – TABELAT	2



Funded by
the European Union

Ky Plan Social Vendor është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi vetëm e autorëve të tij dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Ky Plan Social Vendor publikohet nëpërmjet Asistencës Teknike “Mbështetjes së Bashkimit Evropian për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” (EU4SI), të dhënë nga Bashkimi Evropian për Bashkinë e Konispol, zbatuar nga GOPA Worldwide Consultants.

HYRJE

Ndertohet ne fund

I.MISIONI, VIZIONI, VLERAT DHE PARIMET UDHËRRËFYESE

1.Vizioni

Konispoli, bashkia me një sistem të integruar dhe të aksesueshëm të mbrojtjes sociale, që bashkon parandalimin, ndërhyrjen e hershme dhe riintegrimin, duke e lidhur kujdesin shoqëror me shëndetin, arsimin dhe punësimin për dinjitet, barazi dhe mundësi për çdo qytetar.

2.Misioni

Misioni i Planit Social të Bashkisë Konispol është të ngrejë dhe të garantojë një sistem të integruar e të aksesueshëm të mbrojtjes sociale që parandalon rreziqet, ndërhyrjet herët dhe mbështet riintegrimin, duke e lidhur kujdesin shoqëror me shëndetin, arsimin dhe punësimin—për dinjitet, barazi dhe mundësi për çdo qytetar.

3.Parimet e Planit SocialVendor

Plani Social Vendor i Bashkisë Konispol mbështetet në një qasje gjithëpërfshirëse që vë në qendër të drejtat e njeriut dhe aksesin e barabartë në shërbime, duke adresuar varfërinë, pabarazitë dhe pengesat strukturore që kufizojnë mirëqenien e qytetarëve. Parimet udhëheqëse janë:

Përfshirja sociale: Mundësi dhe qasje e barabartë në shërbime e burime për çdo individ dhe komunitet, me fokus në heqjen e barrierave.

Universaliteti dhe mosdiskriminimi: Qasje e barabartë pa dallim gjinie, moshë, aftësie, etnie, statusi socio-ekonomik apo vendbanimi.

Të drejtat e njeriut dhe dinjteti: Respektim i të drejtave themelore dhe standardeve në çdo ndërhyrje dhe shërbim.

Reduktimi i varfërisë dhe pabarazive: Masa të synuara që zbusin varfërinë, reduktojnë pabarazitë dhe rrisin reziliencën familjare.

Zhvillimi i qëndrueshëm: Balancim i ndikimit social me qëndrueshmërinë financiare e administrative, për rezultate afatgjata.

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave: Ruajtje e privatësisë dhe përpunim i të dhënave sipas ligjit dhe etikës.

Qeverisje e mire: Transparencë, pjesëmarrje qytetare dhe llogaridhënie në planifikim, vendimmarrje dhe raportim.

Bashkëpunimi dhe partneriteti: Koordinim ndërsektorial dhe aleanca me OJF, sektorin privat, institucionet qendrore dhe komunitetin.

Barazia gjinore dhe qasje e ndjeshme ndaj ciklit jetësor: Shërbime që adresojnë nevoja të ndryshme të grave e burrave dhe përgjatë gjithë ciklit jetësor.

Vendimmarrje e bazuar në të dhëna, standarde dhe Monitorim dhe Vlerësim: Vendimmarrje mbi të dhëna; përdorim i standardeve të shërbimit; indikatorë SMART, monitorim dhe vlerësim periodik për përmirësim të vazhdueshëm.

Këto parime janë të rëndësishme për krijimin e një Plani Social që trajton nevojat dhe sfidat sociale të banorëve të Bashkisë Konispol, duke garantuar përfshirje, drejtësi dhe zhvillim të qëndrueshëm të komunitetit.

II. ANALIZA E SITUATËS

1. Kuadri strategjik

Plani Social Vendor hartohet në përputhje me:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Konventën për të Drejtat e Njeriut;
- Konventën për të Drejtat e Fëmijëve;
- Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Kartën Sociale Evropiane (e rishikuar);
- Kartën Evropiane të Autonomisë Lokale;
- Standardet e Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSh);
- Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- CEDAW

Dokumentet strategjike:

- Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2024-2030
- Dokumenti i Përfshirjes Sociale 2024-2028
- Plani Kombëtar i moshimit 2020-2024
- Plani Kombëtar LGBTI+ 2021-2027
- Plani Kombëtar për R&E 2021-2025
- Agjenda e Fëmijëve 2021-2026
- Plani Kombëtar i Veprimit PAK 2021-2025

Korniza e përgjithshme ligjore,¹ mbi bazën e të cilës organizohet dhe realizohet mbrojtja, kujdesi dhe integrimi social përbëhet nga:

- Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 104/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.10107/2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

¹VKM 613/2024-ndryshimi i VKM 111/2018 për ngritjen e FS në nivel vendor

- Ligji nr. 8137/1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” (FZ 20-1996).

2. Nevojat, shërbimet e ofruara dhe boshllëqet

Vlerësimi i nevojave

Të dhënat demografike

Mungojne te dhenat nga Rregjistri Civil Maj 2022-Maj 2025 numer familjesh per cdo njesi administrative ne te total, numer popullsie per cdo njesi adminsitative dhe toal, te ndare sipas gjinise

Të dhënat nga statistikat e mirëqenies dhe shërbimeve sociale

Ndihma Ekonomike për familjen në nevojë

Sipas legjislacionit shqiptar, familje në nevojë konsiderohen familjet pa të ardhura dhe familjet me të ardhura të pamjaftueshme për të përballuar jetesën. Në mungesë të një regjistri me të dhëna për të gjitha familjet në nevojë, analiza bazohet në situatën e familjeve që aktualisht mbështeten me pagesa në cash nga skema e Ndihmës Ekonomike dhe nga Fondi 6% (Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”).

Në maj 2025, skema e Ndihmës Ekonomike mbulon 56 familje me një fond mujor prej 312,593 lekësh, ndërsa 1 rast me status jetimi përfiton 10,200 lekë; në total 57 familje dhe 322,793 lekë pagesa mujore. Paralelisht, Fondi 6% mbështet 6 familje. Këto shifra përfaqësojnë komponentin kryesor të përgjigjes monetare dhe japin bazën për planifikimin e shërbimeve shoqëruese që e shndërrojnë ndihmën në mundësi.

Shpërndarja territoriale nxjerr një profil të qartë rreziku: shumica e përfituesve të NE janë në Xarrë (46 familje), vijuar nga Markat (8) dhe qendra Konispol (3); në Fondin 6%, Markat numëron 4 familje dhe Xarrë 2. Përqendrimi në njësitë rurale i jep përparësi vendosjes së shërbimeve shoqërore lëvizëse pranë Njësi Administrative dhe, sipas rastit, me vizita në familje.

Struktura familjare e përfituesve është kryesisht me madhësi të vogël dhe mesatare: 9 familje me 1 anëtar, 19 me 2, 9 me 3, 11 me 4, 6 me 5, 0 me 6 dhe 2 me mbi 6 anëtarë. Ky profil kërkon kombinim të NE (pagesave cash) me shërbime afër shtëpisë, sidomos për të vetmuarit, të moshuarit dhe familjet me nevoja për kujdes në shtëpi (p.sh, prind i vetëm me fëmijë të vegjël, familje me PAK ose me të moshuar në varësi).

Profili social i përfituesve nënvizon grupe me rrezik të lartë: gra kryefamiljare (13 raste në NE dhe 2 në Fondin 6%), vajza-nëna (32 në NE dhe 8 në Fondin 6%), familje me të paktën një anëtar me PAK (8 në NE dhe 1 në Fondin 6%), familje me të paktën një të moshuar (8 në NE). Rreth 57% e përfituesve të NE janë vajza-nëna, ndaj mbështetja nuk duhet të mbetet vetëm pagesë; NE duhet të shoqërohet me masa konkrete: ngritjen e qendrave komunitare, vizita mujore në shtëpi (sidomos për të moshuar dhe PAK), këshillim prindëror dhe mbështetje për vajzat-nëna (kujdes për fëmijë/transport për shkollë), ndërmjetësim shëndetësor, orientim dhe ndërmjetësim drejt punësimit (kurse të shkurtra praktike), si dhe menaxhim rasti pranë Njësi Administrative.

Tendenca 2023–2025: numri i familjeve me NE zbriti nga 107 (maj 2023) në 48 (maj 2024) dhe u rrit në 56 (maj 2025); fondi kaloi nga 599,170 lekë në 288,696 lekë dhe 312,593 lekë. Me përfshirjen e kategorisë së jetimit, totali shkon në 57 familje dhe 322,793 lekë. Kjo tendencë nuk tregon automatikisht ulje të nevojës sociale dhe duhet vlerësuar bashkë me përbërjen e familjeve, nevojat për kujdes në shtëpi dhe aksesin real në shërbime e punësim.

Aktualisht, në Bashkinë Konispol nuk ofrohen shërbime të strukturuar të kujdesit shoqëror; punonjësit e sektorit social kryejnë vetëm funksione para-shërbimore (parashoqërore), si informim dhe orientim i qytetarëve, identifikim paraprak i rasteve, administrim dokumentacioni, asistencë për aplikim në skema/benefite dhe referim drejt institucioneve përkatëse.

Nevoja prioritare për përmirësimin e situatës së familjeve në nevojë janë:

- ✓ Ngritje shërbimesh shoqërore sipas nevojave, në komunitet dhe në familje.
- ✓ Programe mbështetëse, integruese dhe fuqizuese për vajza-nëna.
- ✓ Ndërgjegjësim i komunitetit për të drejtat, shërbimet dhe raportimin e rasteve.
- ✓ Staf i kualifikuar me role, detyra dhe përgjegjësi të mirëpërcaktuara.

Punëkërkuessit e papunë

Sipas AKPA Sarandë, në Maj 2025, në Bashkinë Konispol janë të regjistruar 68 punëkërkuess të papunë. Struktura sipas grupmoshave tregon dominim të moshës 40+ dhe prani të dukshme në grupet 25–29 dhe 30–39, ndërsa të rinjtë 16–24 janë pak të përfaqësuar. Ky profil sugjeron masa të dyfishta: rikualifikim dhe ndërmjetësim pune për moshat 25+ dhe hyrje të lehtësuara në tregun e punës për të rinjtë.

Arsimi dhe punësueshmëria

Niveli arsimor i punëkërkuessve përqendrohet te arsimi 9-vjeçar (40 nga 68; rreth 58.8%) dhe fillor (20 nga 68; rreth 29.4%); një grup më i vogël ka arsim të mesëm të përgjithshëm (8 nga 68; rreth 11.8%), ndërsa arsimi i mesëm profesional dhe ai universitar pothuaj mungojnë (0 raste). Kjo nënvizon nevojën për kurse të shkurtra, praktike të lidhura me punëdhënësit lokalë (“mëso dhe puno”) dhe orientim drejt kualifikimeve bazë profesionale.

Lidhja me Ndihmën Ekonomike (NE)

Nga 68 të regjistruarit si punëkërkuess të papunë, 8 (11.8%) vijnë nga familje përfituese të NE. Këta janë të përqendruar në Xarrë (6 nga 8; 75.0%) dhe Markat (2 nga 8; 25.0%), ndërsa në qendër Konispol nuk ka raste. Shpërndarja e përgjithshme e punëkërkuessve është: Xarrë 33 (48.5%), Konispol 23 (33.8%) dhe Markat 12 (17.6%). Kjo tregon se masat e punësimit duhen vendosur aty ku është nevoja, pranë Njësisë Administrative Xarrë dhe Markat, dhe me bashkërendim me shërbimet shoqërore.

Formimi profesional

Pjesëmarrja në kurset e formimit profesional është e ulët: 6 nga 68 punëkërkuess të regjistruar kanë marrë pjesë së fundi (8.8%). Pjesëmarrja është përqendruar në pak profile, kryesisht në

bujqësi (3 persona), agroturizëm (2 persona) dhe shërbime (1 person). Prioritet mbetet hapja e cikleve të shkurtra, modulare, me hyrje të shpeshta dhe me praktikë në vend pune, të lidhura me profesionet e kërkesës në zonë.

Papunësia në Konispol ka profil të theksuar të moshave 25+ me kapital arsimor të ulët; thelbi i përgjigjes është “aftësim praktik + ndërmjetësim pune” pranë Njësi Administrative, me targetim për familjet me NE dhe me orientim të veçantë për gratë, vajzat-nëna, PAK etj. Kjo qasje redukton varësinë nga pagesat, rrit punësueshmërinë dhe krijon kalime reale drejt tregut të punës.

Individë me aftësi të kufizuar

Ky seksion përmbledh situatën e personave me aftësi të kufizuara në Konispol, duke theksuar nevojën për shërbime të strukturuar, akses në arsim dhe lidhje me punësimin e mbështetur. Qasja bazohet në vlerësim individual, menaxhim rasti dhe bashkërendim ndër-institucional.

Info mbi grupin

Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë fëmijë, të rritur dhe të moshuar me kufizime funksionale që ndikojnë në jetën e përditshme. Profili lidhet me nevoja për mbështetje në shtëpi, akses fizik dhe komunikim me shërbimet, si edhe me barrë kujdestarie në familje. Vendbanimi rural/urban nuk është kriter për të drejtën në shërbime; përdoret vetëm për planifikim logjistik të ofrimit.

Të dhëna dhe boshllëqe

Të dhënat e majit 2025 tregojnë se në Konispol janë evidentuar 154 PAK, që përbëjnë rreth 3,1% të popullsisë prej 4.898 banorësh; prej tyre 46 janë femra ($\approx 29,9\%$). Sipas kategorive shfaqen 14 para/tetraplegjikë, 31 të verbër dhe 109 “PAK të tjerë”. Në arsim, tabloja mbetet e kufizuar: asnjë PAK në nivelet e mesme apo të larta dhe vetëm 2 fëmijë me AK ndjekin arsimin 9-vjeçar. Për shërbimet, 28,6% e PAK përfitojnë Ndhimës Personal. Krahasuar me vitet 2023–2025, vihet re rritje graduale e personave përfitues të AK të kategorisë “PAK të tjerë”, ndërsa kategoritë e tjera kanë mbetur të pandryshuara. Brenda kategorisë “PAK të tjerë” vihet re një profil i përzier ku 9% janë fëmijë me vështirësi të shëndetit mendor, 7% fëmijë me vështirësi fizike, ndërsa pjesa dërrmuese përbëhet nga të rritur: 47% me vështirësi të shëndetit mendor dhe 37% me vështirësi fizike. Kjo do të thotë se 84% e rasteve janë të rritur dhe se vështirësitë e shëndetit mendor (56%) peshojnë më shumë se ato fizike (44%). Për rrjedhojë, nevoja primare është për mbështetje psiko-sociale dhe shërbime të shëndetit mendor në komunitet, të lidhura me menaxhim rasti, orientim drejt punësimit dhe aftësim praktik për të rriturit; ndërsa për fëmijët kërkohen ndërhyrje të hershme, mbështetje në shkollë dhe, sipas rastit, rehabilitim fizik dhe mjete ndihmëse.

Megjithatë, boshllëqet e informacionit mbeten të theksuara: mungon regjistër funksional (biopsikosocial), nuk ka evidencë sistematike për mjetet ndihmëse dhe barrierat e aksesit, si edhe mungojnë të dhëna të dedikuara për pjesëmarrjen e PAK në tregun e punës, kufizime që vështirësojnë planifikimin dhe matjen e rezultateve.

Shërbimet

Aktualisht 44 persona përfitojnë **shërbimin e Ndhmësit Personal** (të përhershëm ose të herëpashershëm): 14 para/tetraplegjikë, 10 të verbër dhe 20 PAK të tjerë. Si pjesë e përfituesve, peshën më të madhe e zënë PAK të tjerë ($20/44 \approx 45,5\%$). Por, në raport me kategorinë e tyre, mbulimi më i lartë është tek para/tetraplegjikët ($14/14 = 100\%$), pasuar nga të verbrit ($10/31 \approx 32,3\%$), ndërsa PAK të tjerë kanë mbulim më të ulët ($20/109 \approx 18,3\%$). Kjo tregon se shërbimi po arrin mirë rastet me varësi të lartë, ndërsa kërkon zgjerim dhe menaxhim rasti për të rritur përfshirjen e grupeve të tjera, duke mbetur, në çdo rast, shërbim i dhënë sipas vlerësimit të komisionit dhe jo automatik.

Në Bashkinë Konispol mungojnë **shërbimet shoqërore** të strukturuar; praktika fokusohet tek funksionet parashoqërore (informim/orientim, administrim dokumentacioni, referim). Nuk ka vizita të programuara në familje, menaxhim të plotë rasti me plan individual, shërbime pranë NjA-ve dhe protokolle të qarta bashkërendimi me shëndetin, arsimin dhe punësimin.

Vetëm dy fëmijë me AK **ndjekin aktualisht shkollën** 9-vjeçare në Konispol, ndërsa nuk rezultojnë PAK të përfshirë në arsimin e mesëm apo të lartë. Kjo tablo tregon mungesë të kalimit nga arsimi bazë drejt niveleve pasuese dhe, përveç pengesave praktike, reflekton edhe qëndrime familjare hezituse, shpesh shkollimi i fëmijës me AK shihet si “humbje kohe”. Nevojiten fushata të drejtpërdrejta ndërgjegjësimi me prindërit dhe vetë fëmijët me AK, në shkollë dhe në komunitet, që të theksojnë përfitimet e vijimit, të shpjegojnë hapat praktikë të mbështetjes dhe të nxisin kalimin drejt gjimnazit dhe, kur është e mundur, drejt arsimit të lartë. Bashkia nuk ofron të dhëna për punësim apo formim profesional për PAK.

Nevojat për përmirësimin e situatës lidhen me:

- ✓ Ngritjen e shërbimeve shoqërore të specializuara dhe shërbimeve lëvizëse për PAK dhe familjet e tyre, me menaxhim rasti dhe vizita në shtëpi.
- ✓ Rritjen e aksesit në arsim gjithëpërfshirës për PAK, me transport të përshtatur, materiale ndihmëse dhe mësues ndihmës.
- ✓ Staf i kualifikuar dhe i trajnuar, me role e përgjegjësi të qarta dhe supervizim periodik.
- ✓ Aftësim praktik dhe punësim i mbështetur për PAK, me kurse të shkurtra dhe ndërmjetësim të punëdhënësit lokalë.
- ✓ Rritjen e ndërgjegjësimit publik për nevojat e PAK, rolin e komunitetit në mbështetje të PAK dhe potencialin e PAK për të qenë kontributivë në shoqëri si gjithë të tjerët.

Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe/ose përkujdesje

Rubrika “Fëmijët” trajton mbrojtjen sociale të fëmijës sipas kuadrit ligjor kombëtar. Sipas ligjit, fëmijë në rrezik janë ata të ekspozuar ndaj dhunës, abuzimit, neglizhencës, shfrytëzimit/trafikimit, punës së fëmijëve, mungesës së kujdesit prindëror, braktisjes shkollë, situatës së rrugës, konfliktit me ligjin dhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Bashkia ka detyrimin të ngrejë dhe funksionalizojë strukturat e mbrojtjes së fëmijës, Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF), të vendosë mekanizmat e referimit ndër-institucional dhe të ofrojë shërbime parandaluese e mbrojtëse për fëmijët. Kjo rubrikë përcakton orientimin institucional, masat dhe standardet e zbatimit në nivel vendor.

Në Bashkinë Konispol nuk funksionon një shërbim i veçantë i mbrojtjes së fëmijës dhe nuk ka prani të qëndrueshme të OJF-ve; mbulimi kryhet si funksion i deleguar nga specialistët, me kapacitete të kufizuara dhe pa standarde të unifikuara. Megjithatë, të dhënat e grumbulluara dëshmojnë angazhim aktiv të bashkisë në evidentim dhe ndjekje: janë identifikuar 310 fëmijë në nevojë (Konispol 12, Xarrë 193, Markat 105), prej të cilëve 271 në familje me ndihmë

ekonomike, 31 me aftësi të kufizuara (3 në kujdes rezidencial publik), 4 viktima dhune, 3 në konflikt me ligjin, 2 të larguar nga arsimi 9-vjeçar dhe 1 me status jetimi. Funkcioni PMF nuk është formalizuar në organikë dhe në përshkrimet e punës, duke lënë paqartësi në detyra, linja raportimi dhe objektiva; rruga e referimit nuk është e standardizuar (mungojnë protokollet arsim-shëndetësi-polici- bashki dhe kontakti unik në çdo NjA); ndërkohë, sistemi i informacionit nuk është i unifikuar, vërehet mospërputhje e e të dhënave (p.sh. 310/315)² dhe mungon diferencohet e qartë “rreziku për mbrojtje” nga “nevoja socio-ekonomike”.

Nevojat prioritare

- ✓ Formalizimi i delegimit të funksionit PMF.
- ✓ Forcimi i mekanizmit të referimit dhe menaxhimit të rasteve.
- ✓ Ngritja e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës.
- ✓ Ndërtimi i partneriteteve të qëndrueshme me aktorë lokalë (institucione lokale dhe rajonale, OJF etj).

Me formalizimin e funksionit PMF si funksion i deleguar, standardizimin e referimit dhe ngritjen e shërbimeve bazë në komunitet, Bashkia Konispol e kthen angazhimin aktual në sistem funksional mbrojtjeje të fëmijës me ndikim të matshëm brenda 12–24 muajve.

Viktima të dhunës në familje

Gjatë periudhës 2023–2025 në Konispol janë dokumentuar gjithsej 2 raste dhune: 1 rast në 2024 dhe 1 rast në 2025, ndërsa për 2023 ka mungesë të dhënash (asnjë rast i evidentuar). Kjo përkethehet në një mesatare prej $\approx 0,67$ rasti/vit, çka nuk dëshmon mungesën e fenomenit, por rrezik nën-raportimi dhe boshllëqe në identifikim. Në nivel kapacitetesh, rezulton 0 koordinator vendor i dhunës dhe 0 OShC të specializuara aktive në territor; po ashtu mungon një regjistër unik i rasteve dhe protokolle standarde (SOP) për identifikim, referim e ndjekje. Në këto kushte, kanalet e raportimit janë të paqarta dhe mbështetja pas raportimit e pasigurt, duke rritur probabilitetin që rastet të mos evidentohen, të mos ndiqen ose të ndërpriten pa rezultat.

Nevojat kryesore për përmirësimin e identifikimit, referimit dhe mbështetjes së rasteve:

- ✓ Emërimi i Koordinatorit Vendor të Dhunës me SOP të qarta (identifikim–referim–ndjekje) dhe orar kontakti publik.
- ✓ Marrëveshje me shërbime rajonale/OSHC për këshillim psikologjik, mbështetje ligjore, strehim emergjent dhe shoqërim në institucione (kontraktim shërbimi kur mungon oferta lokale).
- ✓ Trajnim i stafit të vijës së parë dhe fushata të targetuara të ndërgjegjësimit në komunitet për rritjen e raportimit të sigurt dhe uljen e stigmatizimit.

Individë/familje në nevojë për strehim social

Bashkia nuk ofron të dhëna mbi shërbimet e strehimit social për kategoritë në nevojë, çka e bën të paqartë si shkallën e kërkesës ashtu edhe prioritetet për përgjigje. Mungesa e një regjistri

² I njëjti fëmijë mund të klasifikohet në më shumë se një kategori rreziku (p.sh. viktima e dhunës dhe pjesë e një familjeje përfutuese të Ndihmës Ekonomike); prandaj totalët ndërkategorike paraqesin listime, jo numër unik fëmijësh.

unik (aplikantë, gjendje banimi, rrezik humbjeje strehimi) dhe e një harte të mundësive (banesë sociale, bonus qiraje, strehim emergjent, përshtatje banese) pengon planifikimin dhe koordinimin me shërbimet sociale, shëndetësore e të punësimit. Si rezultat, rastet rrezikojnë të mbeten në qira të paqëndrueshme, mbistrehim të afërmit ose në rrezik përkeqësimi të situatës socio-ekonomike. Hapi i parë është ngritja e evidencës së kërkesës dhe një procedure të thjeshtuar vlerësimi, së bashku me një pikë referimi në bashki dhe marrëveshje bashkëpunimi me ofrues publikë/privatë për zgjidhje të qëndrueshme të strehimit.

Të moshuar në nevojë për shërbime përkujdesi

Bashkia ka një peshë të lartë të popullsisë së moshuar dhe një kërkesë të dukshme për mbështetje shoqërore. Nga 4 898 banorë sipas Censit 2023, 1 297 janë 65 vjeç e lart, pra rreth 26.5 për qind. Janë evidentuar 252 të moshuar në nevojë (62% gra) dhe 173 persona (57% gra) kanë kërkuar shërbime, kryesisht në familje dhe në qendër ditore. Mungesa e kërkesave për shërbim rezidencial nuk nënkupton mungesë nevojë; mund të reflektojë barriera informacioni/aksesi. Këto të dhëna tregojnë nevojën për shërbime bazë të strukturuar dhe për menaxhim sistematik të rasteve.

Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore

Grupi 65+ përbën rreth një të katërtën e popullsisë, me përqendrim të dukshëm të rasteve në nevojë në NjA Markat. Nga 252 të moshuar në nevojë, 44.4 për qind janë në Markat, 31.0 për qind në Xarrë dhe 24.6 për qind në Konispol. Të moshuarit që jetojnë vetëm janë 61 vetë ose rreth 4.7 për qind e grupit 65+, ndërsa vetëm 12 prej tyre përfitojnë ndihmë ekonomike, çka tregon mbulim të kufizuar të familjeve pa mbështetje. Shfaqen edhe forma të rënda të vulnerabilitetit si braktisja me 77 raste në total, ku 87.0 për qind e tyre janë të përqendruar në Markat, si edhe varfëria me 60 raste dhe sëmundshmëria me 42 raste. Modelet gjinore të kërkesës për shërbime sugjerojnë ekspozim më të lartë të grave në nevojë për mbështetje të përditshme.

Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Të dhënat e disponueshme janë fotografi e një viti dhe nuk shoqërohen me seri kohore për krahasim. Mungon një regjistër elektronik i rasteve, mungon standardizimi i kategorizimeve dhe nuk ekziston një strukturë e dedikuar për moshën e tretë që të ndjekë sistematikisht identifikimin, vlerësimin dhe referimin. Kjo krijon rrezik nënraportimi dhe e vështirëson planifikimin objektiv të kapaciteteve sipas njësive administrative.

Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Në përputhje me Ligjin nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” i ndryshuar, bashkia ka detyrim të organizojë/mbështesë shërbime shoqërore për moshën e tretë. Aktualisht mungojnë shërbimet shoqërore të strukturuar për moshën e tretë dhe bashkia nuk ka një specialist të posaçëm për këtë grup. Megjithatë, kërkesa e shprehur është e lartë. 173 të moshuar kanë kërkuar shërbime, që korrespondojnë me rreth 13.3 për qind të grupit 65+. Prej tyre, 101 persona kërkojnë shërbim në familje dhe 72 kërkojnë shërbim në qendër ditore. Në shërbimin në familje, kërkesa shpërndahet afërsisht 35.6 për qind Konispol, 39.6 për qind Xarrë dhe 24.8 për qind Markat, ndërsa për qendrën ditore 43.1 për qind Konispol, 36.1 për qind Xarrë dhe 20.8 për qind Markat. Nuk ka kërkesa për shërbim rezidencial të regjistruara këtë vit. Këto

modele sinjalizojnë nevojë për mbështetje në aktivitete të përditshme, shoqërim, mbikëqyrje shëndetësore bazë dhe lehtësira komunitare pranë vendbanimit.

Nevojat për ndërhyrje prioritare

- ✓ Specialist i dedikuar për moshën e tretë (identifikim–vlerësim–menaxhim rasti).
- ✓ Regjistër elektronik i rasteve me kategorizim standard dhe raportim periodik.
- ✓ Shërbim në familje me ekip lëvizës në tre NjA.
- ✓ Qendër ditore multifunksionale (shoqërim, aktivitete, ndjekje terapie).
- ✓ Formalizohet bashkëpunimi me mjekun dhe infermierin e familjes për vizita shtëpiake e vlerësim periodik të të moshuarve/PAK jo-lëvizës, me referim të shpejtë te shërbimet shoqërore.

Profili demografik dhe kërkesa e shprehur e bëjnë ndërhyrjen për moshën e tretë një prioritet të qartë. Me vendosjen e një strukture të dedikuar, me bazë të dhënash funksionale dhe me dy shtylla shërbimesh të aksesueshme në komunitet, bashkia mund të kalojë shpejt nga reagimi sporadik në mbështetje të qëndrueshme dhe me ndikim, duke rritur sigurinë, dinjitetin dhe përfshirjen sociale të të moshuarve.

Individë që kanë varësi nga alkooli

Bashkia nuk raporton të dhëna mbi përdoruesit e alkoolit. Shëndetësia ka evidentuar 5 raste dhe policia 14, për një total prej 19 rastesh. Shpërndarja territoriale: Konispol 2 raste, Markat 5 raste, Zarrë 12 raste. Të dhënat prezantojnë nënraportim në Konispol. Në bashki mungon një pozicion në nivel specialist për koordinimin dhe menazhimin e rasteve. Shërbimet shoqërore për përdoruesit e alkoolit dhe familjet e tyre mujojnë totalisht. Bashkia nuk oforn asnjë shërbim shoqëror për personat përdorues droge dhe familjarët e tyre. Mungon gjithashtu një pozicion / specialist në sektorin social që të mbulojë problematikën e nevojat e personave përdorues të alkoolit dhe familjet e tyre.

Nevoja për të ardhmen

- ✓ Regjistër unik bashkiak me deduplikim dhe hartëzim territorial.
- ✓ Pikë kontakti/menaxhim rasti në bashki me rrugë referimi të standardizuara.
- ✓ Mekanizëm ndër-institucional (Bashki–Shëndetësi–Policë–ZVA) me takim mujor dhe raportim tremujor.
- ✓ Fushata ndërgjegjësimi dhe mbështetje familjare (grupe mbështetjeje, trajnime për vijën e parë), me referim drejt shërbimeve rajonale të trajtimit/rehabilitimit.

Individë që kanë varësi nga droga

Bashkia dhe shëndetësia nuk raportojnë të dhëna për përdoruesit e drogës; ndërkohë policia ka evidentuar 21 raste në vitin 2025. Shpërndarja territoriale është: Konispol 3, Markat 4, Zarrë 14 (totali përputhet me 21). Kjo sinjalizon rrezik të shtuar në Zarrë dhe prani domethënëse në Markat, ndërsa qendra ka numër më të ulët rastesh. Meqë evidencat vijnë vetëm nga policia, ka gjasë për nën-raportim të rasteve më të lehta ose atyre familjare që nuk arrijnë në institucion; pa të dhëna nga shëndetësia dhe pa regjistër bashkiak, nuk matet dot rruga nga identifikimi te trajtimi dhe rikthimi në komunitet. Bashkia nuk oforn asnjë shërbim shoqëror për personat

përdorues droge dhe familjarët e tyre. Mungon gjithashtu një pozicion / specialist në sektorin social që të mbulojë problematikat e nevojat e personave përdorues të drogës.

Nevoja prioritare

- ✓ Regjistër unik bashkiak me deduplikim, hartëzim territorial dhe indikatorë bazë (rast i ri, përsëritje, referim).
- ✓ Pikë kontakti dhe menaxhim rasti në bashki
- ✓ Mekanizëm ndër-institucional (Bashki–Shëndetësi–Policë–ZVA) me takime mujore dhe raportim tremujor.
- ✓ Lidhje direkte me trajtimin/rehabilitimin: referim i menjëhershëm te mjeku i familjes dhe qendrat rajonale;
- ✓ Mbështetje për familjet dhe fushata

Persona LGBTIQ+

Bashkia dhe institucionet lokale nuk kanë asnjë të dhënë për personat LGBTIQ+, çka tregon padukshmëri institucionale dhe rrezik të lartë nën-raportimi për shkak të stigmatizimit, mungesës së një pike konfidenciale kontakti dhe mungesës së protokolleve gjithëpërfshirëse. Pa kanale të sigurta raportimi dhe pa bashkërendim me shëndetësinë, arsimin dhe policinë, nevojat për mbështetje psiko-sociale, shëndet mendor, siguri dhe mbrojtje nga diskriminimi mbeten të padokumentuara dhe nuk kthehen dot në shërbime të matshme. Bashkia nuk oforn asnjë shërbim shoqëror për personat LGBTIQ+ dhe familjarët e tyre. Mungon gjithashtu një pozicion / specialist në sektorin social që të mbulojë problematikat e nevojat e personave LGBTIQ+.

Nevojat

- ✓ Pikë kontakti konfidenciale dhe kanal raportimi anonim.
- ✓ Protokolle gjithëpërfshirëse dhe formularë neutralë në të gjitha shërbimet.
- ✓ Trajnim i stafit të vijës së parë për qasje pa paragjykim dhe privatësi.
- ✓ Marrëveshje me shërbime/OSHC rajonale për këshillim psiko-social dhe mbështetje ligjore.
- ✓ Monitorim tremujor me indikatorë të thjeshtë (raportime, referime, ndjekje).

Vlerësimi i nivelit aktual të shërbimeve

Shërbime sociale sipas Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, janë ndërhyrje të strukturuar jo-monetare që synojnë parandalimin, mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të individëve e familjeve në rrezik. Në kuptimin e ligjit, shërbimet ofrohen në forma komunitare, në familje, ditore, rezidenciale dhe lëvizëse, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose përmes kontraktimit të ofruesve jopublikë. Bashkia ka detyrimin t’i krijojë ato (shërbimet) mbi bazën e vlerësimit të nevojave, menaxhimit të rastit dhe referimit ndërsektorial, duke garantuar akses, cilësi dhe llogaridhënie.

Në Bashkinë Konispol, oferta aktuale është e kufizuar dhe e përqendruar kryesisht te Ndihma Ekonomike (56 familje/162 persona); kjo është mbështetje në para dhe nuk përbën shërbim

social të strukturuar. Ndërkohë, evidentohen në nevojë 922 individë:³ 310 fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje, 252 të moshuar, 154 persona me aftësi të kufizuara, 1 viktimë e dhunës në familje, 19 persona me varësi nga alkooli dhe 21 nga droga, si edhe familje në nevojë për strehim social pa të dhëna për mbulim. Hendeku midis nevojës dhe mbulimit tregon mungesë të paketës bazë të shërbimeve në familje dhe komunitet dhe dobësi në menaxhimin e rasteve dhe në referimin ndërsektorial.

Bashkia Konispol është një bashki e vogël me kapacitete njerëzore e financiare të kufizuara. Aktualisht nuk ofron shërbime sociale të strukturuar në komunitet apo në familje; shërbimet e vetme të ofruara janë kryesisht shërbime parashoqërore të ofruara nga stafi I sektorit social. Mungon edhe prania e qëndrueshme e OJF -ve dhe e ofruesve privatë. Funkcionet sociale mbahen në sektorin përkatës (Ndihmë Ekonomike, Mbrojtje Sociale, Arsim/Kulturë), me fokus kryesisht administrativ (verifikime, evidenca, orientim), pa rrjet shërbimesh komunitare.

Nevojat prioritare

- ✓ Ngritja e paketës bazë të shërbimeve jo -monetare ditore, në familje dhe lëvizëse me fokus te fëmijët në rrezik, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit.
- ✓ Vendosja e menaxhimit të rasteve me role të qarta për PMF dhe Koordinatorin e Dhunës dhe funksionalizimi i referimit ndërsektorial përmes NJVRN dhe protokolleve të standardizuara.
- ✓ Krijimi i një sistemi të rregullt identifikimi dhe regjistrimi me bazë të dhënash, profilizim të nevojave për 922 individët dhe indikatorë të matshëm cilësie.
- ✓ Fuqizimi i kapaciteteve dhe burimeve përmes shtimit të stafit social, trajnimeve, linjave buxhetore të dedikuara dhe kontraktimit të OJF -ve sipas Ligjit nr. 121/2016.
- ✓ Zbatimi i programeve parandaluese dhe rehabilituese në komunitet për varësitë dhe dhunën dhe orientimi për strehim me kanale të qarta aksesimi.

Konispoli ka bazën ligjore dhe potencialin për ta kthyer hendekun e sotëm në shërbime konkrete që sjellin ndryshim. Duke vendosur paketën bazë të shërbimeve jo - monetare, menaxhimin e rasteve dhe referimin e unifikuar, bashkia garanton mbrojtje dhe përfshirje reale për 922 qytetarët në nevojë. Fuqizimi i stafit dhe kontraktimi i OJF -ve e shndërron mbështetjen nga pagesa në shërbime cilësore, të matshme dhe pranë komunitetit. Me angazhim dhe llogaridhënie, standardi i Ligjit nr. 121/2016 bëhet i prekshëm për çdo familje në Konispol.

Analiza e burimeve njerëzore

Sektori i Ndihmës Ekonomike, Mbrojtjes Sociale, Arsimit dhe Kulturës është pjesë e Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm dhe Integritetit Evropian; i raporton drejtorit të drejtorisë dhe linja e brendshme e varësisë vijon te përgjegjësi i sektorit dhe më tej te specialistët.

Sektori administron Ndihmën Ekonomike dhe PAK, duke kryer pritje dhe verifikim aplikimesh, përditësim dosjesh, përgatitje listash mujore dhe borderosh, kontroll të ligjshmërisë, trajtim ankesash dhe hartim materiali për shqyrtim në Këshillin Bashkiak.

³ I njëjti përfitues mund të klasifikohet në më shumë se një kategori; prandaj listimet ndërkategorike nuk përfaqësojnë numër unik personash

Përgjegjësi i sektorit planifikon dhe organizon punën, mbikëqyr zbatimin e procedurave/standardeve dhe koordinon me strukturat brenda dhe jashtë bashkisë; specialisti i nivelit të lartë për ndihmën dhe kujdesin social zbaton legjislacionin dhe udhëzimet, mban evidencat periodike dhe bashkërendon me strukturat rajonale/komisionet; specialisti i ndihmës ekonomike dhe mbrojtjes sociale identifikon/verifikon raste, harton dosje dhe ndjek praktikën administrative; specialisti i arsimit, kulturës dhe sportit administron jetën kulturore dhe aktivitetet komunitare.

Sektori identifikohen fëmijë dhe kategori të tjera në nevojë, çka tregon se funksione të mbrojtjes së fëmijës (PMF) dhe të referimit ndërsektorial (NJVRN) realizohen de facto nga stafi i sektorit; megjithatë, këto role nuk janë të formalizuara në organikë dhe nuk shoqërohen me përshkrime pune të përafuara me standardin. Ndihma Ekonomike është mbështetje monetare dhe nuk klasifikohet si shërbim social i strukturuar.

Fokusi i sektorit mbetet kryesisht administrativ, ndërsa rrjedha e menaxhimit të rastit nuk dokumentohet si cikël i plotë (identifikim–vlerësim–plan shërbimi–referim–mbyllje), mungon një regjistër unik i rasteve për shërbimet shoqërore dhe rolet ligjore PMF, Koordinatori i Dhunës dhe sekretariati i NJVRN nuk janë të formalizuara.

Nevojat prioritare të burimeve njerëzore

- ✓ Formalizimi i PMF si pozicion i dedikuar me përshkrim pune, objektiva dhe linja raportimi në organikë.
- ✓ Emërimi i Koordinatorit të Dhunës dhe Barazisë Gjinore me mandat ndërsektorial dhe përgjegjësi të qarta për referim dhe ndjekje.
- ✓ Krijimi i sekretariatit të NJVRN dhe standardizimi i protokolleve të referimit me arsim, shëndetësi dhe polici.
- ✓ Vendosja e regjistrat unik të rasteve për shërbimet shoqërore dhe dokumentimi i plotë i rrjedhës së menaxhimit të rastit.
- ✓ Rishikimi i rregullores dhe përshkrimeve të punës për të zhvendosur fokusin nga proceset monetare të shërbimeve shoqërore dhe menaxhimi i rasteve.

Analiza SWOT për realizimin e Planit Social Lokal në Bashkinë Konispol

Analiza SWOT për realizimin e Planit Social Lokal në Bashkinë Konispol ofron një vlerësim të thelluar të faktorëve që ndikojnë në zhvillimin e shërbimeve sociale. Pikat e forta si partneritetet me organizata, përvoja në projektet sociale dhe potenciali për punësim krijojnë një bazë të mirë për përmirësimin e situatës. Megjithatë, dobësitë si mungesa e të dhënave të detajuara dhe kapacitetet e kufizuara institucionale përbëjnë sfida serioze. Në të njëjtën kohë, ekzistojnë mundësi të rëndësishme për zhvillimin e shërbimeve komunitare dhe rritjen e financimeve, por këto duhen parë përballë kërcënimeve si emigrimi, mungesa e fondeve të qëndrueshme dhe burokracia..

III. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi

Të vendoset një sistem i shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Konispol që është i aksesueshëm, me cilësi dhe llogaridhënie, i bazuar në menaxhimin e rasteve dhe referimin ndërsektorial, për parandalim, mbrojtje dhe përfshirje sociale të grupeve në rrezik.

Prioriteti 1 — Qeverisje dhe përgjegjësi funksionale

Objektivi 1: Përmirësimi i shërbimit ndaj qytetarit: Institucionalizimi i strukturave të menaxhimit të rasteve përmes formalizimit të PMF, Koordinatorit të Dhunës dhe sekretariatit të NJVRN, me linja të qarta raportimi, protokolle të unifikuara dhe regjistër unik.

Masa 1.1: Miratimi i akteve të brendshme për PMF, Koordinatorin e Dhunës dhe sekretariatit të NJVRN.

A 1.1.1 Hartimi dhe miratimi i rregullores.

Tregues: Aktet e miratuara dhe të publikuara brenda afatit vjetor.

Masa 1.2: Standardizimi i protokolleve me arsim, shëndetësi dhe polici (NJVRN).

A 1.2.1 Përditësimi dhe nënshkrimi i protokolleve të referimit dhe të mbledhjeve të rregullta.

Tregues: 5 protokolle të nënshkruara dhe 4 mbledhje në vit të realizuara.

Objektivi 2: Rritja e kapaciteteve të stafit: Reagim i shpejtë dhe profesional ndaj kërkesave për mbështetje përmes cikleve të rregullta trajnimi e supervizimi, balancimit të ngarkesës sipas roleve dhe sigurimit të mjeteve e hapësirave të përshtatshme të punës.

Masa 2.1: Trajnim dhe supervizion profesional i stafit social.

A 2.1.1 Cikël trajnimesh në menaxhimin e rasteve, mbrojtjen e fëmijës, dhunën në familje dhe mbrojtjen të dhënave.

Tregues: Plan trajnimi i zbatuar dhe pjesëmarrje $\geq 80\%$ e stafit target.

Prioriteti 2: Rrjeti i shërbimeve të kujdesit shoqëror në komunitet

Vendosja e shërbimeve ditore, në familje dhe lëvizëse për grupet prioritare, me referim të integruar ndërsektorial, kanale të qarta aksesimi dhe ofrim nga strukturat bashkiake ose, sipas ligjit, edhe përmes ofruesve jopublikë, me fokus te cilësia dhe rezultatet për mbrojtje dhe përfshirje sociale.

Objektivi 1: Sistemi bazë i shërbimeve të kujdesit shoqëror në komunitet funksionon plotësisht në format ditor, në familje dhe lëvizës, me cilësi, llogaridhënie dhe rezultate të matshme në mbrojtje dhe përfshirje sociale.

Masa 1.1 Shërbime ditore për grupet prioritare (fëmijë në rrezik, persona me aftësi të kufizuara, të moshuar).

A 1.1.1 Ngritja dhe funksionimi i shërbimeve multifunksionale ditore,

Tregues: Qendra e ngritur, 50 persona marrin shërbime në qendër

Masa 1.2: Shërbime në familje dhe lëvizëse.

A 1.2.1 Ngritja dhe funksionimi i shërbimit lëvizës për të moshuar dhe PAK

Tregues: Shërbimi i ngritur dhe funksional, 50 të moshuar përfitojnë shërbime në familje

Objektivi 2: Garantimi i mbrojtjes së koordinuar, me standarde, për fëmijët dhe rastet e dhunës, i mbështetur në funksionimin e plotë të NJVRN dhe në informimin e qytetarëve

Masa 2.1: Operacionalizimi i referimit ndërsektorial për rastet në rrezik.

A 2.1.1 Takime periodike të NJVRN dhe konferenca rastesh me institucionet partnere.

Tregues: 2 takime në vit, 40 persona pjesmarrës.

Masa 2.2: Informim dhe akses i qytetarëve.

A 2.2.1 Fushata ndërgjegjësuese për komunitetin

Tregues: 9 fusharta në vit, 1000 persona marrin pjesë në fshata

Objektivi 3: Ndërtimi i partneriteteve të qëndrueshme me OJF/ofrues jopublikë dhe institucione publike për shërbime të specializuara në komunitet, me standarde dhe indikatorë të qartë dhe monitorim periodik të cilësisë.

Masa 3.1: Bashkëpunimi me OJF/ofrues për shërbime të specializuara.

A 3.1.1 Marrveshje të realizuara me OJF& institucione publike dhe jo publike për ofrimin e shërbimeve shoqërore

Tregues: 3 Marrëveshje bashkëpunimi aktive, 3 projekte të realizuara

Fondi i nevojshëm për realizimin e Planit Lokal Social

Objektivi Specifik	Fondi I nevojshem	Burimi Financimit	
		Bashkia	Donatore
OS 1			
OS 2			
Total			

IV. PLANI I VEPRIMIT

MATRICA E PLANIT VENDOR SOCIAL BASHKIA KONISPOL

Qëllimi i Përgjithshëm është krijimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe të aksesueshëm të mbrojtjes sociale që adreson në mënyrë efektive nevojat e individëve dhe familjeve në rrezik përjashtimi social.

Objektivi specifik 1 (OS1): Përmirësimi i kapaciteteve institucionale për ofrimin e shërbimeve sociale

Objektivat	Aktiviteti	Indikatori	Afati i zbatimit		Buxheti dhe Burimi I financimit	Institucionet përgjegjëse	
			Afati i fillimit	Afati i mbarimit		Drejtorja/S ektori/Departamenti(Udheheqes)	Institucion kontribues (nese ka)

Prioriteti 2 :

Objektivat	Aktiviteti	Indikatori	Afati i zbatimit		Buxheti dhe Burimi financimit	Institucionet përgjegjëse	
			Afati i fillimit			Drejtorja/S ektori/Depa	Institucion kontrib

				Afati i mbari mit		rtamenti(U dheheqes)	ues (nese ka)

V. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Monitorimi dhe vlerësimi i Planit Social Lokal të Bashkisë Konispol është një proces i vazhdueshëm që synon të sigurojë zbatimin efektiv të masave të parashikuara, matjen e ndikimit të tyre dhe përmirësimin e vazhdueshëm të politikave sociale. Ky proces bazohet në qasje të dhënash të verifikuara, indikatorë të matshëm dhe përfshirjen e aktorëve kyç në analizimin e progresit.

Qasja e Monitorimit

Bashkia Konispol ka përcaktuar një mekanizëm monitorimi të strukturuar, i cili përfshin:

- Indikatorë të qartë matës për vlerësimin e zbatimit të shërbimeve sociale, si numri i përfituesve, përmirësimi i aksesit në shërbime dhe shkalla e realizimit të objektivave të planit.
- Grumbullimin e rregullt të të dhënave nga njësitë administrative, institucionet sociale dhe organizatat partnere.
- Përdorimin e teknologjisë për krijimin e një databaze digjitale që lehtëson monitorimin në kohë reale të shërbimeve sociale.
- Raportime vjetore, të cilat do të analizojnë progresin dhe sfidat në zbatimin e planit.

Procesi i Vlerësimit

Vlerësimi i Planit Social Lokal do të kryhet në dy nivele:

1. Vlerësimi i vazhdueshëm (procesi i monitorimit) – Përfshin analizën e të dhënave mbi ndikimin e politikave sociale dhe shërbimeve në komunitet.
2. Vlerësimi përfundimtar – Pas përfundimit të periudhës së planit, do të bëhet një analizë gjithëpërfshirëse mbi përmbushjen e objektivave dhe ndikimin e politikave të zbatuara.

Ky vlerësim do të ndihmojë në: i) Identifikimin e boshllëqeve dhe përmirësimin e strategjive të ardhshme; ii) Përcaktimin e nevojës për ndryshime në ndarjen e burimeve dhe orientimin e fondeve; iii) Rritjen e transparencës dhe përfshirjen e komunitetit në vlerësimin e politikave sociale.

Përfshirja e Aktorëve Lokalë

Për të siguruar një monitorim dhe vlerësim të besueshëm, në këtë proces do të angazhohen:

- Njësitë administrative dhe sektori i shërbimeve sociale, të cilat do të raportojnë mbi progresin e shërbimeve.
- Organizatat e shoqërisë civile, të cilat do të ndihmojnë në identifikimin e nevojave reale të komunitetit dhe vlerësimin e ndikimit të ndërhyrjeve sociale.
- Komuniteti dhe grupet e interesit, përmes mekanizmave të konsultimit publik dhe feedback-ut mbi efektivitetin e masave të zbatuara.

VI. ANEKSI 1 – TABELAT

Të dhëna mbi Numrin e familjeve përfituese të NE në vite

Kategoritë përfituese të NE	Maj 2023		Maj 2024		Maj 2025	
	Nr.	Fond Lek	Nr.	Fond Lek	Nr.	Fond Lek
Familje përfituese të NE	107	599,170	48	288,696	56	312,593
Individë me status jetimi			1	10,200	1	10,200
Individë viktima të trafikimit						
Individë viktima të dhunës						
Prindër me më shumë së dy fëmijë të lindur njëherësh						
a) trinjakë						
b) Katënjakë						
c) Pesë e më shumë së fëmijë të lindur njëherësh						
Fëmijë të vendosur në familje kujdestare						
Fëmijë me aftësi të kufizuar të vendosur në familje kujdestare						
Total	107	599,170	49	298,896	57	322,793

Tabela mbi strukturen e familjes përfituese të NE në maj 2025

Familje	Nr
Me 1 anëtar	9
Me 2 anëtar	19
Me 3 anëtar	9
Me 4 anëtar	11
Me 5 anëtar	6
Me 6 anëtar	0
Mbi 6 anëtar	2
Total	56

Karakteristikat e familjeve përfituese të NE Maj 2025

Njësité Administrative	Familje perfituese per Njesi Administrative	Gra kryefamiljare	Vajza nena	Familje me anetar me AK	Familje R&E	Familje me anetar te moshuar
Konispol	3	3	4	0	0	0
Xarra	46	8	15	8	1	4
Markati	8	2	13	0	0	4
Total	57	13	32	8	1	8

Karakteristikate e familjeve perfituese nga Fondi 6% Maj 2025

Njësité Administrative	Familje perfitues e te 6%	Gra kryefamiljar e	Vajza nena	Familje me anetar me AK	Familje R&E	Familje me anetar te moshuar
Konispol	0	0	0	0	0	0
Xarra	2	0	2	0	1	0
Markati	4	2	6	1	0	0
Totali	6	2	8	1	1	0

Të dhëna mbi familjet përfituese të NE në nivel Njësie administrative muaji Maj 2025

Njësia Administrative	Nr familjes h përfitues e të NE	Anëtarët të familjeve përfituese të NE sipas grupmoshës dhe gjinise							
		0-15 vjeç		16-18 vjeç		18-67 vjeç		mbi 67 vjeç	
		Total	% vajza	Total	% vajza	Total	% vajza dhe gra	Total	% gra
Konispol	3	3	33%	0	0%	3	100%	0	
Xarra	46	35	45.00 %	12	33.00 %	90	48.00%	2	0.00
Markat	7	5	60.00 %	0		5	40.00%	4	
Total	56	43	1.38	12	0.33	98	1.88	6	0

Të dhëna mbi papunësinë sipas karakteristikave të përgjithshme në nivel Bashkie

Grup-mosha	Urban	Rural	Sipas gjinisë		Sipas statusit			
			Femra	Meshkuj	PAK	Romë/ Egjiptiane	Emig - rantë të kthyer	Gra krye-familjar e

16-19 vjeç						0		
20-24 vjeç								
25-29 vjeç			1	8		0		
30-39 vjeç			9	5		0		
40+			22	23		0		10
Total			32	36		0		10

Papunësia sipas nivelit arsimor

Niveli arsimor	Femra	Meshkuj	TOTALI
pa arsim			
Fillore			20
9-vjeçare			40
E mesme përgjithshme			8
E mesme profesionale			
Arsimi Universitar			
Total			68

Të dhëna mbi individë të familjeve përfituese të NE të regjistruar si punëkërkuar sipas AKPA

NJËSIA ADMINISTRATIVE	PUNËKËRKUESE TOTAL	PUNËKËRKUESE PËRFITUESE TË NE
Konispol	23	0
Xarra	33	6
Markat	12	2
Total	68	8

Te dhena per kurset e formimit profesional

NJËSIA ADMINISTRATIVE	Numri I persona e qe ndjekin kurset e formimit profesional	Sipas gjinise		Sipas grupmoshes			
		F	M	14-18 vjec	19-25 vjec	26-50 vjec	Mbi 50 vjec
Konispol	1	4	2		3	3	
Xarra							
Markat	5						
TOTAL BASHKIA	6		2		3	3	

Përfitimi i pagesës së aftësisë së kufizuar në vite

Kategori perfiturese te AK	2023	2024	2025
----------------------------	------	------	------

Para dhe tetraplegjike	14	14	14
Të verbër	29	31	31
Invalidë	206	203	0
PAK të tjerë	103	106	109
Total 1+2+3+4	352	354	154

Të dhëna analitike mbi përfitimn e pagesës së aftësisë së kufizuar

Pershkrimi	Maj 2023			Maj 2024			Maj 2025		
	Num er PAK	Femr a	Sa prej tyre femra në %	Num er PAK	Femr a	Sa prej tyre femra në %	Num er PAK	femr a	Sa prej tyre femra në %
1. Para dhe tetraplegjike	14	5	35.71 %	14	5	35.71 %	14	2	14.29 %
i) <i>Bashkia/Konis pol</i>	2	0	0.00%	2	0	0.00%	2	0	0.00%
ii) <i>Xarra /Markati</i>	12	5	41.67 %	12	5	41.67 %	12	2	16.67 %
2 Të verbër	29	10	34.48 %	31	9	29.03 %	31	9	29.03 %
i) <i>Bashkia/Konis pol</i>	4	2	50.00 %	7	0	0.00%	7	0	0.00%
ii) <i>Xarra / Markat</i>	25	8	32.00 %	24	9	37.50 %	24	9	37.50 %
3 Invalidë	209	107	51.20 %	200	83	41.50 %	0	0	0.00%
i) <i>Bashkia/Konis pol</i>	57	47	82.46 %	53	25	47.17 %	0	0	0.00%
ii) <i>Njësitë Administrative</i>	152	60	39.47 %	147	58	39.46 %	0	0	0.00%
4 PAK të tjerë	103	47	45.63 %	106	48	45.28 %	109	35	32.11 %
i) <i>Bashkia/Konis pol</i>	22	11	50.00 %	25	12	48.00 %	22	10	45.45 %
ii) <i>Xarra /Markat</i>	81	36	44.44 %	81	36	44.44 %	87	25	28.74 %
Total 1+2+3+4	355	169	47.61 %	351	145	41.31 %	154	46	29.87 %

Analiza e përtimit të Ndihmës Personal

Pershkrimi	Numer mesatar PAK përfitues të Ndhësit Personal		
	Maj 2023	Maj 2024	Maj 2025
1. Para dhe tetraplegjike	14	14	14
i) Bashkia/Konispol	2	2	2
ii) Xarra/ Markati	12	12	12
2 Të verbër	10	8	10
i) Bashkia/Konispol	1	1	1
ii) Xarra/ Markati	9	7	9
3 Invalidë	0	0	0
i) Bashkia/qytet	0	0	0
ii) Xarra / Markati	0	0	0
4 PAK të tjerë	17	16	20
i) Bashkia/Konispol	4	4	5
ii) Xarra/Markat	13	12	15
Total 1+2+3+4	41	38	44

Fëmijë në kategorinë “PAK të tjerë” sipas gjinisë

Njësia Administrative	Fëmijë me AK		
	Total	F	M
Konispol	8	2	6
Xarra	18	9	9
Markati	5	2	3
Total	32	11	21

Të dhëna për personat me Aftësi të Kufizuar “PAK të tjerë” Maj 2025/ Sipas vleresimit biopsikosocial

Njësia Administrative	Te mitur						Te rritur					
	PAK Mendor			PAK Fizik			PAK Mendor			PAK Fizik		
	Total	F	M	Total	F	M	Total	F	M	Total	F	M
Konispol	4	0	4	0	0	0	10	5	5	8	4	4
Xarra	4	3	1	3	3	1	30	13	17	25	9	16
Markat	2		2	5	3	2	12	7	5	8	0	8
Total	10	3	7	8	6	3	52	25	27	41	13	28

Njesitë Administrative	Numri i Kopshteve	Nr femijeve total			Fëmijë total te ndare sipas kategorive						
		Total	F	M	Fëmijë nga familje me NE	Fëmijë me status jetimi	Në Kujdestati	PAK	Etni rom/Egjiptian	Viktim a të dhunës dhe trafiki mit	Të tjere
Bashkia total	8	120	54	66	0	0	0	0	0	0	0
Bashkia (qyteti) Konispol	3	58	25	33	0	0	0	0	0	0	0
Xarra	4	48	20	28	0	0	0	1	0	0	0
Markati	1	14	8	6	0	0	0	0	0	0	0

Numri i shkollave publike 9 vjeçare dhe numri i nxënësve

	2023			2024			2025		
	Numri i Shkolla	mesatar fëmij	Fondi	Numri i Shkollave	Nr mesatar fëmijësh	Fondi	Numri i Shkollave	Nr mesatar fëmijësh	Fondi
i) Bashkia/Konispol	1	207	0	1	199	0	1	192	0
ii) Xarra/,Markati	7	245	0	7	239	0	7	231	0
ii) grupe femijesh ne klasa									0
Total grupe									

Fëmijë në nevojë sipas NjA

Njësia Administrative	Total	F	M
Konispol	12	6	6
Xarra	193	103	90
Markati	105	53	52
Total	310	162	148

Të dhëna për situatën aktuale të fëmijëve në nevojë

Përshkrimi	Total	F	M
Fëmijë në konflikt me ligjin	3		3
Të shfrytëzuar për punë			
Viktima të trafikimit/të mundshme trafikimi			
Jetim	1	1	
Fëmije 0-18 vjeç në familje me NE	271	144	127
Fëmijë me AK	31	13	18
Fëmijë viktima të dhunës	4	4	
Fëmijë në shërbim kujdesi alternative			
Nr. total i fëmijëve në kujdes rezidencial në fund të vitit			
Nr. fëmijëve në shtëpinë e foshnjës në fund të vitit			

Nr. i fëmijëve me AK në kujdes rezidencial publik (në të gjitha institucionet) në fund të vitit	3		3
Fëmijë në situatë ruge			
Fëmijë që kanë braktisur shkollën (arsimi i mesëm)	2		2
Total	315	162	153

Të moshuar në nevojë sipas NjA

Njësia Administrative	Total
Konispol	62
Xarra	78
Markati	112
Total	252

Të dhëna për moshën e tretë

		Konispol	Xarra	Markati	Total
Kërkojnë shërbim në familje	Total	36	40	25	101
	F	22	23	12	57
	M	14	17	13	44
Kërkojnë shërbim në qendër ditore	Total	31	26	15	72
	F	18	17	7	42
	M	13	9	8	30
Kërkojnë shërbim rezidencial	Total		0	0	0
	F		0	0	0
	M		0	0	0
1-Total të moshuar që kërkojnë shërbime		67	66	40	173
Nr i të moshuarve që jetojnë vetëm dhe që përfitojnë NE	Total				12
		1	5	6	
	F	1	3	6	10
	M	0	2	0	2
Të moshuar të vetmuar	Total				61
		26	20	15	
	F	16	15	12	43
	M	10	5	3	18

Të moshuar të sëmurë	Total	15	17	10	42
	F	11	13	7	31
	M	4	4	3	11
Të moshuar të braktisur	Total		10	67	77
	F		3	34	37
	M		7	33	40
Të moshuar të varfër	Total	20	26	14	60
	F	14	15	7	36
	M	6	11	7	24
2-Total të moshuar në nevojë		62	78	112	252

Tabela 21. Tabela e shërbimeve ekzistuese dhe nevojat për shërbime